

**RI- SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	<b>Specialist (Ethical Hacker)</b>	Reparti Ushtarak nr.6601	Tiranë	Pa afat	Po	Po	07.08.2023	21.08.2023

Formulari nr. 1

<b>1.Pozicioni i punës:</b> Specialist (Ethical Hacker), në Sektorin Special të Sigurisë Kibernetike, në Njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.
<b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A
<b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak Nr.6601, Shtabi i Përgjithëm i Forcave të Armatosura.
<b>4. Vendi:</b> Tiranë
<b>5. Paga:</b> VKM nr.325, datë 31.05.2023
<b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat
<b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 07.08.2023
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 21.08.2023
<b>9. Mënyra e aplikimit:</b>  Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:  <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i>  <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i>  <i>Tiranë</i>

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al) (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

### a. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

**b. Grada/Titulli:** Civil/Specialist (Ethical Hacker)

**c. Arsimi :** Të zotërojë diplomë Bachelor në inxhinieri për TIK.

**d. Kualifikimi:** Të zotërojë diplomë master profesional/shkencor në Siguri Kibernetike ose barasvlershme me to.

**e. Trajnimi:** Të zotërojë një Certifikatë Certified Ethical Hacker (CEH). Të zotërojë [CompTIA Security+](#) certifikatë për TI professional.

**f. Eksperiencia në Punë:** Jo më pak se **3 (tre) vjet eksperiencë** në mjediset e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit duke përfshirë njohuri mbi trajtimin e incidenteve, angazhimin në përgjigje ndaj incidenteve/eventeve të sigurisë duke qenë pjesë e strukturave të ndërlidhjes në FA ose në trajtimin e incidenteve/eventeve të sigurisë së shërbimeve në rrjetet kompjuterike.

**g. Gjuha e huaj:** Anglisht

**h. Kërkesa të tjera specifike:** Njohuri të strukturave kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë (ENISA, NIST, ITIL, AKCESK, ISO, OWASP etj.) Te ketë njohuri për Linux, Windows dhe sisteme aktuale operimi. Njohuri të thella të manipulimit të parametrave, rrëmbimit të sesioneve (session hijacking) dhe skriptimit në faqe (cross-site scripting). Të jete i azhurnuar me mjetet, teknikat dhe procedurat e hakerimit, strategjitë e sulmeve dhe mbrojtjes; elementët e politikave efektive të mbrojtjes; praktikat më të mira të sigurisë bazuar në host, vazhdueshmëria e biznesit dhe rigjenerimi, dhe standarde dhe produktet e kriptimit.

**i. Niveli i certifikatës së sigurisë:** Teper Sekret dhe NATO Secret. Te plotesoje kriteret për tu pajisur me certifikate të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015.

## 12. Përshkrimi i punës:

**Deklarimi i pozicionit:** Kryen funksione në përgjigje ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike/kompjuterike në sektorin special të sigurisë kibernetike, siguron veprime të drejtpërdrejta në trajtimin dhe përgjigjen kundrejt incidenteve/eventeve të sigurisë mbi baza të përditshme dhe përgjigjet ndaj eventeve kritike në rrjetet kompjuterike të MM/SHPFA.

### Detyrat kryesore:

1. Kryen kërkime të vazhdueshme në sistemet kompjuterike të FA, duke kërkuar për pika të mundshme të depërtueshme e të cenueshme në rrjet.
2. Identifikon dhe regjistron të meta dhe shkelje të sigurisë.
3. Identifikon dhe raporton porta të hapura, konfigurime të shfrytëzueshme në pajisjet e rrjetit dhe protokolle të cenueshëm.
4. Harton dhe sugjeron rekomandime për të përmirësuar sigurinë e rrjetit.
5. Ka njohuri të përditësuara me teknologjitë e fundit lidhur me kërcënimet e fundit dhe kryen trajnime të brendshme për personelin e NJUSK.

## 13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta.  
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë/shkrim.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë/shkrim.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë/shkrim me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.